



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:201382

Datë: 21.05.2024

Numri i dokumentit: 05714666

PPP.nr.945/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Florian Krasniqi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit B.N, të cilin e përfaqëson shoqëria e avokatëve avokat B.N., avokat nga Prishtina, kundër debitorit Kompania e Sigurimeve “E”, në çështjen juridike përmbarimore për pagimin e borxhit, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.534/2021, të datës 10.06.2021, të lejuar nga përmbaruesi privat Eset Murati, në Prishtinë, jashtë seance, me datë 21.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **REFUZOHET** në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Kompania e Sigurimeve “E...” i paraqitur kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit, P.nr. 534/2021, të datës 10.06.2021, të lejuar nga përmbaruesi privat Eset Murati, në Prishtinë.
- II. **MBETET NË FUQI** urdhri për lejimin e përmbarimit, P.nr. 534/2021, i datës 10.06.2021, i lejuar nga përmbaruesi privat Eset Murati, në Prishtinë.

A r s y e t i m

Zyra përmbarimore e përmbaruesit privat Eset Murati në Prishtinë ka lëshuar urdhrin për lejimin e përmbarimit, Nr. 534/2021, të datës 10.06.2021, me të cilin ka obliguar debitorin Kompania e Sigurimeve “...”. që kreditorit brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit

përmbartimor t'ia paguajë shumat si në vijim: 135,311.33 euro në emër të borxhit kryesor, me kamatë ligjore prej 8 % në vit e cila do të fillojë të llogaritet nga data 03.01.2023, e deri në kohën e përlllogaritjes së ekspertit financiar, shumë në prej 6,556.75 euro në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, dhe shpenzimet e tjera të procedurës së përmbartimit. Përmbartimi është lejuar bazuar në titullin përmbartimor Aktgjykim, me nr. III.EK.nr. 196/2013, i datës 24.04.2017, i nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike.

Brenda afatit ligjor, prapësim ka paraqitur debitori i përmbartimit, duke e kundërshtuar urdhrin përmbartimor me arsyetimin se: për të njëjtën çështje dhe me të njëjtin titull përmbartimorë janë iniciuar dy procedura përmbartimore, dhe krahas urdhrin përmbartimor të goditur me këtë prapësim, është lëshuar edhe urdhëri përmbartimorë tek përmbartuesi privat Eset Murati, i cili urdhër mbanë numrin P.nr. 858/19, ndërsa në Gjykatën Themelore në Prishtinë, mban numrin PPP. 756/19, e cila është në procedurë e sipër. Ka shtuar në prapësim se, duke qenë se procedura tjetër përmbartimore nën numrin PPP. 756/19 e cila është në zhvillim e sipër në Gjykatë, kreditori e ka të sigurtë që do të vendoset në disfavor të saj, i njëjti ka iniciuar procedurë tjetër të përmbartimit me të njëjtin titull përmbartimor. Ka theksuar se, inicimi i një procedure tjetër përmbartimore, është duke i krijuar shpenzime debitorit dhe se këto veprime të kreditorit janë keqpërdorim i të drejtës së kreditorit që të tërhiqet në çdo fazë të procedurës nga propozimi për përmbartim edhe pse e njëjta është në fazën e fundit të vendosjes në mënyrë meritore për prapësimin e debitorit. Debitori në prapësimin e tij e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor edhe me arsyetimin se, kreditori nuk është i autorizuar që të kërkojë përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartimor dhe ka theksuar se po ti referohemi shkresave të lëndës rezulton se kreditori ka bashkëngjitur një prokurë ku vërehet se është e nënshkruar nga ana e personit fizik B.N.. Tutje ka theksuar se bazuar në faqen zyrtare të agjencisë për regjistrimin e bizneseve në Kosovë, shihet që N.P.T N. me nr. të biznesit me datë 17.06.2017 është shuar dhe se ky biznes gjatë kohës sa ishte aktiv, ishte në pronësi të B.N dhe me drejtor B.N.. Tutje në prapësim, debitori ka theksuar se, kreditori nuk mund të jetë palë në procedurë pasi që është shuar me datë 17.06.2017 dhe po ashtu ka pretenduar se është parim i së drejtës se njërat ndër format e shuarjes së obligimeve është me vdekjen e palës ose me shuarjen e personit juridik. Mbi këto pretendime të lartë theksuara, ka konkluduar se meqenëse entiteti biznesor N.P.T. N është shuar, edhe të gjitha autorizimet e dhëna nga i njëjti janë shuar dhe se e njëjta nuk mund të paraqitet si palë në procedurë. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit dhe ta shfuqizojë urdhrin për lejimin e përmbartimit.

Brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori i përbarimit, B.N. Në përgjigje në prapësim ka theksuar se, pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim nuk kanë asnjë mbështetje ligjore dhe se debitori nuk ka argumentuar kundërshtimet e tij në prapësim me asnjë dispozitë ligjore. Ka shtuar se debitori kundërshtimin e tij e mbështet në faktin se paraprakisht është iniciuar procedura përbarimore për të njëjtën çështje me nr. P.nr. 858/19 (tutje sipas prapësimit PPP. 756/2019), mirëpo sipas nenit 42.1 dhe 3 të Ligji për Procedurën Përbarimore propozimi për përbarim mund të tërhiqet tërësisht apo pjesërisht gjatë zhvillimit të procedurës përbarimore pa pëlqimin e debitorit dhe një propozim i tillë mund të paraqitet përsëri. Ka theksuar se kreditori me qëllim të evitimit të disa pengesave procedurale përcjellur me gabime teknike përkitazi me subjektivitetin e kreditorit, ka vendosur që ta tërheqë propozimin për përbarim P.nr. 858/2019 dhe e ka parashtruar sërish një propozim të ri, i cili është aprovuar me urdhrin P.nr. 534/21, datë 09.06.2021. Tutje ka deklaruar se sa i përket pretendimet të debitorit për jo validitetin e autorizimit një pretendim i tillë është i pabazuar dhe i paargumentuar, madje edhe referimi në nenin 90.2 të LPK nuk është adekuat, sepse dispozita në fjalë vetëm rregullon vëllimin e autorizimit personit i cili është avokat. Tutje ka shtuar se një pretendim i tillë për validitetin e autorizimit (se autorizimin e ka nënshkruar një person fizik) nuk hynë në shkaqet e prapësimit të parapara me nenin 71 të LPP-së. Ka theksuar tutje se, sa i përket pretendimit të debitorit se kreditori nuk mund të jetë palë në procedurë për shkak të shuarjes së personit juridik, në këtë rast nuk kemi të bëjmë me person juridik, por B.N B.I ka qenë i regjistruar si biznes individual dhe se forma e tillë e organizimit të shoqërisë tregtare nuk është person juridik, dhe se kreditori B.N. ka përgjegjësi të pakufizuar personale si për borxhet dhe detyrimet tjera, ashtu edhe për kreditë nga biznesi individual.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas studimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi është i pabazuar.

Gjykata fillimisht sqaron se, kjo lëndë sipas prapësimit është regjistruar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ndërsa pas themelimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, lënda është bartur në Gjykatën Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, dhe ka marr numrin: KPPP.nr.682/22. Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin KPPP.nr.682/22, të datës 29.06.2023 është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore, dhe lëndën e ka dërguar në kompetencë të mëtutjeshme pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me arsyetimin se propozimi për përbarim është paraqitur nga B.N. si person fizik. Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, ka hapur

konfliktin për kompetencë pranë Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ndërsa Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin nr. CN.nr.28/2023, të datës 16.08.2023, kishte vendosur që kompetente për të vendosur sipas prapësimit të debitorit është Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil.

Sa i përket titullit përmbarrimor mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarrimi, Gjykata ka vlerësuar titullin përmbarrimor - aktgjykimin me nr. III.EK.nr. 196/2013, i datës 24.04.2017, në bazë të të cilit organi përmbarrues ka lejuar përmbarrimin, dhe vlerëson se aktgjykimi në fjalë paraqet titull përmbarrimor në bazë të të cilit mund të iniciohet procedura e përmbarrimit. Me nenin 22, par. 1, pika 1.1. të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore (në vijim të tekstit referuar si: LPP), parashihet që dokument përmbarrimor paraqet: *vendimi përmbarrues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbarruese*. Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, dokumenti përmbarrimor në bazë të të cilit është iniciuar procedura e përmbarrimit është i përshtatshëm për përmbarrim, konform dispozitës së nenit 27 të LPP-së, me të cilën dispozitë parashihet: *Dokumenti përmbarrimor është i përshtatshëm për përmbarrim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*. Në dokumentin përmbarrimor – aktgjykimin në bazë të të cilit është iniciuar procedura e përmbarrimit, janë caktuar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes, andaj Gjykata vlerëson se dokumenti përmbarrimor i plotëson të gjitha kushtet për të qenë bazë për përmbarrim dhe po ashtu i njëjti dokument është i përshtatshëm për përmbarrim. Po ashtu titulli përmbarrimor është i vulosur me vulën e plotfuqishmërisë me datë 02.10.2019 dhe me vulën e ekzekutueshmërisë me datë 26.11.2019.

Referuar pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, Gjykata vlerëson se të njëjtat janë të pa bazuara dhe të pa mbështetura në prova, siç parashihet me nenin 69 paragrafi 4 të LPP-së, e cila parasheh: *Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet*.

Debitori në prapësim, ndër të tjera ka pretenduar se për të njëjtën çështje janë iniciuar dy procedura përmbarrimore dhe atë procedura e iniciuar nga subjekti juridik N.P.T. N, e cila procedurë pranë përmbarruesit privat ka marrë numrin P.nr. 858/19, ndërsa në Gjykatën Themelore në Prishtinë, mban numrin PPP. 756/19, ndërsa tani kreditori ka paraqitur edhe propozim tjetër në emrin e tij personal si B.N. Referuar këtij pretendimi të debitorit, Gjykata sjell në vëmendje se, procedura e përmbarrimit është iniciuar në bazë të titullit përmbarrimor -

Aktgjykimit me nr. III.EK.nr. 196/2013, i datës 24.04.2017, i nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë, departamenti për çështje ekonomike. Sipas këtij titulli përmbarimor – aktgjykimi, cilësinë e paditësit – kreditorit e kishte entiteti biznesor N.P.T. N, me nr. të biznesit 70434068, me seli në M. Subjekti juridik N.P.T N kishte paraqitur propozim për përmbarim pranë përmbaruesit privat Eset Murati, i cili kishte nxjerrë urdhrin përmbarimor me nr. 858/2019, datë 27.11.2019, dhe lënda gjendet në Gjykatën Komerciale të Kosovës, dhomat e shkallës së parë. Nga shkresat e lëndës, si dhe nga vet deklaratimet e palëve (sipas prapësimit dhe përgjigjes në prapësim) rezulton se entiteti biznesor N.P.T. N është shuar me datë 17.06.2017, kështu që pronari i subjekti juridik N.P.T. N ka paraqitur propozim të ri për përmbarim, i cili është kundërshtuar sipas prapësimit për të cilin kjo Gjykatë vendosi me këtë aktvendim.

Sidoqoftë, në këtë situatë janë të rëndësishme dy fakte vendimtare për tu qartësuar. Së pari, se kreditori pranë kësaj Gjykate ka dorëzuar parashtresën me të cilën e ka njoftuar Gjykatën se propozimin për përmbarim, në lëndën P.nr. 858/2019 e cila gjendet pranë Gjykatës Komerciale e ka tërhequr. Së dyti Gjykata vlerëson se fakti se në një Gjykatë tjetër të kompetencës lëndore, gjendet lënda tjetër e iniciuar sipas propozimit për përmbarim të paraqitur nga N.P.T N (tashmë biznes i shuar) nuk mund të ndikojë në vendosje sipas prapësimit të vendosur me këtë aktvendim, sepse sipas vlerësimit të kësaj Gjykate gjyqvarësia nuk mund të krijohet ndërmjet Gjykatave të kompetencës së ndryshme lëndore. Kjo për faktin se gjyqvarësia nënkupton rastet kur dy procedura gjyqësore zhvillohen ndërmjet të njëjtave palë ndërgjyqëse dhe për objektin e njëjtë të kontestit (në rastin konkret objekt i përmbarimit), kështu që sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, për të njëjtën çështje nuk mund të jenë kompetente dy gjykata të kompetencave të ndryshme lëndore. Ndërsa, në rastin konkret, procedura e parë e përmbarimit është iniciuar nga subjekti juridik N.P.T N, ndërsa në rastin e vendosur me këtë aktvendim, iniciues i procedurës përmbarimore është B.N si person fizik, andaj sipas vlerësimit të kësaj gjykate vendosja sipas prapësimit të debitorit ndaj propozimit të kreditorit me këtë aktvendim, si e tillë është e pavarur dhe nuk mund të ndikohet nga propozimi tjetër për përmbarim i cili është paraqitur nga një shoqëri tregtare me organizim biznes individual. Për më tepër, siç është theksuar më lartë, pas hapjes së konfliktit për kompetencë, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës me vendimin CN.nr.28/2023, të datës 16.08.2023 ka vendosur që kompetencë lëndore për të vendosur lidhur me këtë çështje përmbarimore ka kjo Gjykatë.

Debitori po ashtu ka pretenduar se kreditori nuk është i autorizuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit, për arsye se borxhi sipas titullit përmbarimor është në emër të shoqërisë tregtare

N.P.T. N, i cili është tashmë i shuar. Sa i përket këtij pretendimi, Gjykata vlerëson se, duke u bazuar në atë që nga vet palët është pohuar fakti se biznesi individual N.P.T. N me nr. të biznesit 70434068 është shuar (fakt ky i cili vërtetohet edhe nga regjistri online i bizneseve të Kosovës), meqenëse subjekti juridik në fjalë ishte i organizuar si biznes individual, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pronari i biznesit individual ka të drejtën që të kërkojë përmbushjen e kërkesave ndaj palëve të treta, pavarësisht faktit se biznesi individual është shuar. Kjo për faktin se bazuar në Ligjin nr. 06/1 -016 për Shoqëritë Tregtare, gjegjësisht nenit 48, par. 1 të këtij ligji është përcaktuar se: *Një person mund të ketë vetëm një Biznes Individual. Personi i cili është pronar i një Biznesi Individual, ka përgjegjësi të pakufizuar personale për të gjitha borxhet dhe detyrimet tjera të shkaktuara, ose të imponuara nga një ligj ose kontratë, në një Biznes Individual. Kjo përgjegjësi është e pa-kufizuar dhe përfshin tërë pronën dhe asetet e çfarëdo lloji që janë në pronësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të këtij Personi, pavarësisht nga fakti se nëse prona ose asetet e tilla shfrytëzohen për qëllime afariste, personale apo shtëpiake, përveç pronës ose asetëve të përcaktuara në ligjin në fuqi për procedurën përmbarimore, dhe kur: 1.1.kontrata e cila e ka krijuar këtë përgjegjësi shprehimisht e përjashton nga përgjegjësia pronën ose asetet; 1.2. personi ose shoqëria tregtare që ka pretendime është pajtuar që këto asetet ose prona të mos i nënshtrohen pretendimeve të tij.* Ndërsa me paragrafin 3 të nenit 48 të Ligjit për shoqëritë tregtare parashihet: *Biznesi Individual nuk është person juridik. Pavarësisht nga kjo, ai mund të lidhë kontratë, të ketë pronë, të ushtrojë padi dhe të jetë i paditur, në emrin e Biznesit Individual apo të pronarit.*

Bazuar në dispozitën e lartë cituar ligjore, rezulton se biznesi individual nuk e ka statusin e personit juridik, megjithatë të njëjtit i është njohur e drejta që jetë palë kontraktuese, të disponojë me prona, të jetë palë në procedura gjyqësore në emrin e biznesit individual apo të pronarit. Thënë thjeshtë, biznesi individual mund të jetë pjesëmarrës në qarkullimin juridik dhe ekonomik të mallrave dhe shërbimeve dhe mund të hyjë në të drejta dhe detyrime me palët tjera. Dispozita e nenit 48 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare ka përcaktuar se nga operimi ekonomik i biznesit individual, pronari i biznesit individual përgjigjet me tërë pasurinë e tij individuale ndaj palëve të treta, pa asnjë kufizim (me përjashtim të kufizimeve të parapara me Kontratë të veçantë). Duke qenë kështu, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, përderisa pronari i biznesit individual në mënyrë të pakufizuar përgjigjet për të gjitha detyrimet e biznesit individual ndaj palëve të treta, rrjedh interpretimi se i njëjti po ashtu ka të drejtë që të kërkojë përmbushjen e të gjitha kërkesave që palët e treta i detyrohen biznesit individual të regjistruar në emër të pronarit. Në rastin konkret, me titullin përmbarimor – aktgjykimin nr. III.EK.nr. 196/2013, i datës 24.04.2017, është obliguar

debitori që biznesit individual N.P.T. N t'ia paguajë borxhin si në propozim për përmbarim dhe përgjatë zhvillimit të procedurës ankimore biznesi individual është shuar, dhe në një situatë të tillë, sipas vlerësimit të kësaj Gjykata tani kreditori B.N. në cilësinë e ish pronarit të biznesit individual ka të drejtën të kërkojë përmbushjen e detyrimit sipas titullit përmbarimor të lartë cituar.

Tutje debitori në prapësimin e tij ka pretenduar se: *kreditori nuk mund të jetë palë në procedurë pasi që është shuar me datë 17.06.2017*, megjithatë një pretendim i tillë i debitorit i paraqitur në prapësim është i pabazuar, kjo për faktin se kreditor i përmbarimit në këtë procedurë përmbarimore është kreditori B.N. si person fizik, e jo biznesi individual i cili ka qenë i regjistruar në emër të tij, dhe siç është sqaruar më lartë në këtë aktvendim, shuarja e biznesit individual nuk i' a shuan të drejtën pronarit të biznesit individual të shuar që të kërkojë përmbushjen e obligimeve që palët e treta kanë ndaj biznesit që ka qenë i regjistruar në emrin e tij.

Po ashtu është i pabazuar edhe pretendimi i debitorit i paraqitur në prapësim, përmes të cilit ka pretenduar se *është parim i së drejtës se njërat ndër format e shuarjes së obligimeve është me vdekjen e palës ose me shuarjen e personit juridik*. Gjykata sjell në vëmendje nenin 340 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve i cili përcakton se: *Me vdekjen e debitorit ose të kreditorit shuhet detyrimi vetëm në qoftë se është krijuar duke marrë parasysh veçoritë personale të njërit nga palët kontraktuese ose aftësitë personale të debitorit*. Bazuar në këtë dispozitë ligjore përcaktohet se me vdekjen e kreditorit ose debitorit shuhen vetëm ato detyrime të cilat janë krijuar duke pasur për bazë aftësitë dhe/ose veçoritë personale të kreditorit ose debitorit (*intuitu personae*) dhe fakti se në një marrëdhënie detyrimi ka vdekur personi fizik ose është shuar personi juridik, nuk nënkupton apriori edhe shuarjen e të gjitha detyrimeve reciproke ndërmjet palëve. Në rastin konkret, rezulton se detyrimi sipas titullit përmbarimor është krijuar nga baza e shkaktimit të dëmit dhe një detyrim i tillë nuk është krijuar duke pasur për bazë veçoritë personale të asnjërës nga palët (kreditorit apo debitorit).

Sa i përket pretendimit të debitorit ku ka deklaruar në prapësim se: *po ti referohemi shkresave të lëndës rezulton se kreditori ka bashkëngjitur një prokurë ku vërehet se është e nënshkruar nga ana e personit fizik B.N.*, Gjykata një pretendim të tillë e gjen të pabazuar dhe të pa provuar me prova relevante, kjo për faktin se, autorizimi i cili gjendet në shkresat e lëndës për përfaqësuesin e kreditorit është nënshkruar nga personi fizik – kreditori, ngase vet kreditori është subjekti që

ka paraqitur propozimin për përmbarrim, dhe pretendimet e debitorit për jo validitetin e autorizimit që kreditori e ka dhënë për përfaqësuesin e tij janë të pabazuara dhe pa ndikim për një vendosje tjetër.

Si përfundim, Gjykata vlerëson se prapësimi i debitorit është i pabazuar, ngase debitori nuk ka ofruar prova përmes të cilave do të argumentonte se përmbushen ndonjëri nga shkaqet e prapësimit të parapara me nenin 71 të LPP-së, ndonëse sipas nenit 69 par. 4 të LPP-së është paraparë detyrimi i debitorit që për pretendimet në prapësim të paraqet provat që i provojnë ato pretendime.

Nga arsyet e paraqitura në bazë të nenit 73 të LPP-së, kjo gjykatë gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
PPP.nr.945/2021, datë 21.05.2024

Gj y q t a r i
Florian Krasniqi

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar
Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të
njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e
Apelit në Prishtinë.